

## Konstituimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë: Fillimi i ushtrimit të kompetencave në drejtim të ngritjes së Gjykatave të Posaçme dhe SPAK

Konstituimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), shënon fillimin e një faze më të avancuar të procesit të ngritjes së Gjykatave dhe Strukturës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Ndër hapat e parë që dy Këshillat duhet të marrin janë emërimi i gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme dhe prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme. Sipas parashikimeve ligjore këto procese duhet të realizohen brenda dy muajve.

Kushtetuta (neni 179/8) parashikon që Gjykatat e Posaçme të emërtohen, funksionojnë dhe ushtrojnë kompetencat brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky afat është gjithashtu i parashikuar në Kushtetutë edhe për prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, të cilët duhet të emërohen brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

## Ngritja e Gjykatave të Posaçme: Emërimi i Gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme (GJP)

### ▪ *Kriteret dhe kushtet për gjyqtarët e GJP*

Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Shkalla e Parë do të ketë minimalisht 16 gjyqtarë, ndërsa ajo e Apelit I 11 gjyqtarë. Gjyqtarët e Gjykatave të Posaçme do të emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe përpara emërimit ato duhet ti nënshtrohen dhe kalojnë me sukses tre kritere:

1. verifikimin e pasurisë dhe figurës (vetting-un);
2. plotësojnë kriteret e ngritjes në detyrë; dhe
3. japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikacione vetjake.

Pavarësisht këtyre kriterëve, për 16 gjyqtarët aktualë të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe 12 gjyqtarët aktualë të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda është garantuar mundësia e kalimit dhe **emërimit të përkohshëm** në Gjykatat e Posaçme duke plotësuar fillimisht vetëm kriterin e tretë: pëlqimin për rishikimin periodik të llogarive të tyre financiare dhe të telekomunikimeve vetjake, si dhe për anëtarët e afërt të familjes.

**Emërimi i përhershëm** i gjyqtarëve të cilët janë emëruar përkohësisht në detyrë në Gjykatat e Posaçme do të realizohet vetëm nëse ata/ato plotësojnë të treja kriteret më lart. Në të

kundërt nëse gjatë vlerësimit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit gjyqtarët marrin masë disiplinore, përfundon dhe caktimi i tyre i përkohshëm, pavarësisht procesit të ankimit.

- *Kompetencat e KLGJ-së në drejtim të emërimit të gjyqtarëve*

Institucioni përgjegjës ku do të dorëzohen deklaratat respektive të nënshkruara nga gjyqtarët në detyrë është Këshilli i Lartë Gjyqësor. Ndërkohë edhe gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda për të cilët ka filluar procesi i rivlerësimit në shkallë të parë nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, emërohen përkohësisht në nivelin përkatës të Gjykatës së Posaçme me vendim të KLGJ 2 javë nga krijimi i këtij organi.

Këshilli i Lartë Gjyqësor u konstitua në datën 20 dhjetor 2018, ndërkohë që në mbledhjen e datës 27 dhjetor 2018 vendosi nisjen e procedurave për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve pranë Gjykatave së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Emërimi i përhershëm i gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme duhet të përfundojë brenda 2 muajve nga krijimi i Këshillit.

	<b>Emërohen përkohësisht gjyqtarët në Gjykatën e Posaçme brenda dy javëve nga krijimi</b>	<b>KPK kryen Vetting për gjyqtarët e pa rivlerësuar</b>	<b>Emëron në mënyrë të përhershme gjyqtarët brenda 2 muajve nga krijimi</b>
<b>KLGj</b> (konstituar 20 Dhjetor 2018)	3 Janar 2019	Për rreth 1 muaj e gjysëm	20 Shkurt 2019

- *Kufizimi i lirisë personale dhe rivlerësimi ndër sfidat kryesore në emërimin e përkohshëm dhe të përhershëm të gjyqtarëve në GJP*

Nuk mund të parashikohet se sa gjyqtarë do të jenë të gatshëm të japin pëlqimin për kufizimin e lirisë personale dhe kalimin në Gjykatën e Posaçme. Përsa i përket kalimit të procesit të rivlerësimit, nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, vetëm 1 gjyqtar është konfirmuar dhe është zgjedhur anëtar i KLGJ, ndërkohë që nga 12 gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda vetëm 1 prej tyre është konfirmuar nga KPK.

Nëse një numër i konsiderueshëm i gjyqtarëve aktualë në Gjykatat e Krimeve të Rënda nuk do të pranojnë të nënshkruajë deklaratat për kontrollet periodike, kjo do të sillte mungesë të numrit të nevojshëm të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme. Megjithëse KLGJ do të duhet të rihapë thirrjen për aplikime, dakordësia për kufizimin e privatësisë e bën konfirmimin e përkohshëm të numrit të nevojshëm të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme një proces të shtrirë në kohë. Gjithashtu numri i vogël i gjyqtarëve të Krimeve të Rënda, të cilët kanë kaluar vetting-un do të kërkojë kohën e nevojshme për emërimin e tyre të përhershëm.

<b>Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Emri/Mbiemri</b>	<b>Pozicioni</b>	<b>Vendimi i KPK</b>
1.	Sandër Simoni	Kryetar/Gjykata e Shkallës së Parë	
2.	<b>Dritan Hallunaj</b>	<b>Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë</b>	<b>Konfirmuar/Anëtar i KLGJ</b>
3.	Ardit Mustafaj	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	
4.	Irena Gjoka	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	
5.	Daniela Shirka	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	
6.	Etleva Deda	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	
7.	Luan Hasneziri	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	
8.	Flora Hajredinaj	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	
9.	Fran Prendi	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	
10.	Ilirjana Olldashi	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	
11.	Liljana Baku	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	
12.	Marsela Balili	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	
13.	Bib Ndreca	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	
14.	Miliana Muça	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	
15.	Klodian Kurushi	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	
<b>Gjykata e Apelit për Krime të Rënda</b>			
1.	Fehmi Petku	Kryetar/Gjykata e Apelit	
2.	Gjovalin Pernoca	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	
3.	<b>Nertina Kosova</b>	<b>Gjyqtare/Gjykata e Apelit</b>	<b>Konfirmuar</b>
4.	Dhurata Haveri	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	
5.	Nure Dreni	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	
6.	Saida Dollani	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	
7.	Dhimitër Lara	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	
8.	Sokol Binaj	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	
9.	Amarildo Laçi	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	
10.	Gurali Brahimllari	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	
11.	Idriz Mulkurti	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	
12.	Albana Boksi	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	

\* Lista e gjyqtarëve të renditur në tabelë i referohet faqeve zyrtare të institucioneve respektive: Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ([www.gjkr.gov.al](http://www.gjkr.gov.al)) dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ([www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al))

## **Ngritja e Prokurorisë së Posaçme: Emërimi i Prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme (PP)**

### **▪ *Kriteret dhe kushtet për prokurorët e PP***

Prokuroria e Posaçme do të përbëhet nga të paktën 10 prokurorë, të cilët sipas përcaktimit të Kushtetutës do të duhet të emërohen brenda 2 muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Emërimi i prokurorëve të posaçëm kryhet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi kandidatët për prokurorë të kenë plotësuar kriteret më poshtë:

1. kontrolli i verifikimit të pasurisë dhe të figurës (vetting-u);
2. dhënia e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake;
3. dhënia e pëlqimit prej anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake.

Në ndryshim nga mundësia e emërimit të përkohshëm të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme, për prokurorët të cilët do të kandidojnë për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme rekrutimi do të kryhet nga fillimi, sipas një procesi aplikimi të hapur, dhe kandidatët duhet që më parë të jenë konfirmuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

### **▪ *Kompetencat e KLP-së në drejtim të emërimit të prokurorëve të posaçëm***

Konstituimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë u realizua në 19 dhjetor 2018, me zhvillimin e mbledhjes së parë dhe zgjedhjen e kryetarit dhe zv/kryetarit. Pavarësisht kësaj, koordinimi i aspekteve logjistike të Këshillit, të cilat kanë patur të bëjnë me përgatitjen e godinës dhe ambienteve të punës apo përgatitjen e një faqe zyrtare website të nevojshme për aplikimet, mund të ndikojnë në mbarvajtjen cilësore dhe kohore gjatë përmbushjes së kompetencave ligjore të KLP.

Në mbledhjen e tretë që Këshilli zhvilloi në datën 7 janar 2019, ndër pikat kryesore të diskutuara në drejtim të ngritjes së Prokurorisë së Posaçme ishin:

- ✓ shpallja e thirrjes për aplikimet e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme; (7 Janar 2019)
- ✓ përcaktimi i numrit të prokurorëve në PP; (15 prokurorë të posaçëm)
- ✓ përcaktimi i kriterëve dhe përvojës profesionale që këto kandidatë duhet të plotësojnë;
- ✓ përcaktimi i afatit kohor të aplikimit; (jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e shpalljes së njoftimit).

### **▪ *Respektimi i afateve ligjore dhe përmbushja e kushteve kryesore të kandidatëve***

Një moment mjaft i rëndësishëm i përzgjedhjes dhe emërimit të kandidatëve për prokurorë lidhet gjithashtu me respektimin e afateve kohore gjatë ushtrimit të të gjitha kompetencave të përshkruara më lart, të cilat filluan të zbatohen me konstituimin e Këshillit të Lartë të

Prokurorisë në datën 19 dhjetor 2018. Brenda dy muajve nga krijimi i saj, parashikohet që KLP të përfundojë emërimin e 15 prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme. Ky afat përkon me datën 19 Shkurt 2019.

Megjithëse për pozicionin prokuror në Prokurorinë e Posaçme mund të aplikojë çdo prokuror që plotëson 3 kushtet kryesore, dhe kriteret e tjera profesionale të vendosura nga KLP, ndër kandidatët kryesorë të mundshëm përfshihen edhe 22 prokurorët e Prokurorisë së Shkallës së Parë dhe Apelit për Krimeve të Rënda. Megjithatë deri tani vetëm 3 prej tyre i janë nështruar procesit të rivlerësimit. Nga këta vetëm 2 janë të disponueshëm, pasi 2 nga prokurorët janë zgjedhur anëtarë në KLP.

<b>Prokuroria e Krimeve të Rënda</b>			
	<b>Emri/Mbiemri</b>	<b>Pozicioni</b>	<b>Vendimi i KPK</b>
1.	Donika Prela	Drejtuese/Prokuroria e Krimeve të Rënda	
2.	<b>Besnik Muçi</b>	<b>Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda</b>	<b>Konfirmuar</b>
3.	<b>Dritan Prençi</b>	<b>Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda</b>	<b>Konfirmuar</b>
4.	<b>Gentjan Osmani</b>	<b>Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda</b>	<b>Konfirmuar/Anëtar i KLP</b>
5.	Arenc Çela	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	
6.	Olsian Çela	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	
7.	Behar Dibra	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	
8.	Njazi Seferi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	
9.	Ened Nakuçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	
10.	Elisabeta Imeraj	Prokurore/Prokuroria e Krimeve të Rënda	
11.	Përparim Kulluri	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	
12.	Doloreza Musabelliu	Prokurore/Prokuroria e Krimeve të Rënda	
13.	Eugen Beci	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	
14.	Klodian Braho	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	
15.	Edvin Kondili	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	
16.	Blerim Tominaj	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	
17.	Vladimir Mara	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	
18.	Manjola Kajana	Prokurore/Prokuroria e Krimeve të Rënda	
19.	Pranvera Hoxha	Prokurore/Prokuroria e Krimeve të Rënda	
20.	Sonila Muhametaj	Prokurore/Prokuroria e Krimeve të Rënda	
<b>Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda</b>			
1.	Artan Bajrami	Drejtuës/Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda	
2.	<b>Bujar Sheshi</b>	<b>Prokuror/Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda</b>	<b>Konfirmuar/Anëtar i KLP</b>

\* Lista e prokurorëve të renditur në tabelë i referohet listës zyrtare të publikuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në Shortet e datave: 12.12.2017; 15.1.2018 dhe 17.09.2018.

Duke qenë se kalimi me sukses i vetting-ut është parakusht kryesor për emërimin e kandidatëve, KLP mund ti kërkojë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit rivlerësimin me përparësi të atyre kandidatëve të pa rivlerësuar të kualifikuar në listën e KLP-së si kandidatë

për në Prokurorinë e Posaçme. Megjithatë, nëse afati 2 mujor do të respektohej, KPK-së do ti mbeteshin më pak se 2 javë kohë për të përmbyllur procesin e rivlerësimit.

Në këtë mënyrë, referuar afateve ligjore, afateve të deritanishme të aplikimit dhe numrit të kandidatëve të mundshëm të pa rivlerësuar, vetting-u megjithëse është një nga hapat kyç dhe të domosdoshëm të procesit, përbën edhe një nga sfidat e tij në drejtim të respektimit të afateve ligjore të përcaktuara për ngritjen e Gjykatave të Posaçme dhe SPAK.

	Shpall njoftimin për aplikim <b>të paktën dy javë</b> përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të tyre në <i>website</i> -in e institucionit	Specifikon afatin përfundimtar të aplikimit, <b>jo më pak se dy javë</b> nga data e publikimit;	KPK kryen Vetting për prokurorët e pa rivlerësuar	Emëron prokurorët <b>brenda 2 muajve</b> nga krijimi
<b>KLP</b> (konstituar 19 Dhjetor 2018)	7 Janar 2019 ( <a href="http://www.klp.al">www.klp.al</a> )	6 Shkurt 2019	Në më pak se dy javë	19 Shkurt 2019